

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Naime Ahmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.S nga P, Lagja “K.D”, zona jug, Rr. “H.O”, (B), të cilën e përfaqëson, avokati N.P nga P, sipas autorizimit, kundër të paditurës S.A nga P, tani me bani në fshatin Ç, Komuna e G, për vërtetimin e pronësisë, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prani të palëve ndërgjyqëse, më 20.03.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses S.S nga P, dhe VËRTETOHET se paditësja në bazë të kontratës së shitblerjes dt.24.08.2000, të lidhur me të paditurën S.A-shitëse dhe bashkëshortit të saj A.S-blerës, e ka fituar të drejtën pronësore në banesën-podrumin e adaptuar në P, Lagja B.D, Rr. ‘‘H.O’’, Banesa (podrum), me sipërfaqe: 46,80 m², e evidentuar si njësi kadastrale: ... ZK, P.

II. Detyrohet e paditura S.A nga P, që paditëses t’ia njoh të drejtën nga pika I. e këtij dispozitivi.

III. Ky aktgjykim do të shërbejë si titull juridik, për regjistrimin e së drejtës së pronësisë në regjistrat e palujtshmërive në Drejtorinë për Pronë dhe Kadastër të Komunës së P, si pasuri e përbashkët e bashkëshortëve.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor, në fjalën përfundimtare ka parashtruar se, bashkëshorti i saj A.S, ka lidhur kontratë mbi shitëblerjen e banesës me të paditurën S.A nga P, në vitin 2000, të banesë e cila gjendet në P, Lagja B.D, Rr. ‘‘H.O’’, Banesa. (podrum), me sipërfaqe: 46,80 m², dhe që nga ajo kohë jemi në pronësi të pa kontestuar nga askush. Padinë e kemi ushtruar në emrin tim meqenëse, konsiderojmë se, është pronë e përbashkët e të dy bashkëshortëve, që të dy kemi kontribuar në mënyrë të barabart në blerjen e banesës. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditëses ka deklaruar se me provat e administruara është vërtetuar se e paditura S.A, të drejtën pronësore për banesën-bodrumin, e kishte fituar në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbindërtim të Ndërtesave dhe shëndrrimin e lokaleve të përbashkëta në banesa, Gazeta Zyrtare e Kosovës, nr.14/88, ndërsa me Kontratën e datës 24.08.2000, këtë të drejtë e ka bartur tek paditësja. Prestimet janë përmbushur në tërësi. Andaj ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadis në tërësi si të bazuar, ashtu siç është përcaktuar në seancë. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

E paditura në përgjigje në padi dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes në cilësi të palës ka deklaruar se banesa – podrumi më është lejuar nga banorët për adoptime pastaj me vendimin e Komunës së Prishtinës, të datës 30.09.1998, më është lejuar që të bëhet adaptimi i podrumit dhe që i njëjti të bëhet i banueshëm në sipërfaqe si në ekspertizën e përpiluar. Në vitin 2000, ja kam shitur paditëses gjegjësishtë me bashkëshortin e saj kemi lidhur kontratë, çmimi kontraktues

në shumë prej 25.000 DM (njëzet e pesë mijë marka gjermane), më është paguar në tërësi, nuk e kontestojë, ngase në tërësi është përmbushë kontrata.

Në fjalën përfundimtare, e paditura deklaron se, nuk e kundërshton padinë e paditëses, kontrata është përmbushur në tërësi dhe i propozon gjykatës që në këtë çështje të vendosë në mënyrë meritore.

Shpenzimet procedurës nuk i ka kërkuar.

Andaj, gjykata bazuar në nenin 148 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006), vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që erdhi në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me parag.1, të nenit 148, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006). Ndërsa, në anën tjetër, gjykata nuk gjeti ndonjë pengesë ligjore të paraparë me paragrafin 2, të nenit të cekur më lartë, të cilat do të ndikonin në mos marrjen e këtij aktgjykimi. Në shkresat e lëndës gjinden prova të mjaftueshme të cilat e vërtetojnë bazën juridike të kërkesëpadisë, si dhe legjitimitetin aktiv dhe pasiv të palëve. Gjithashtu, me ekspertizën e gjeodezisë, të punuar nga eksperti: L.D – gjeodet, e datës 07.10.2017, është konstatuar se, gjendja faktike është në përputhje me marrëveshjen midis palëve kontraktuese për shitblerjen e kësaj paluajtshmërie, banese-podrumi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marr në bazë të nenit 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (Ligji Nr.03/L-006).

Mbi bazën e të dhënave si më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
C. nr. 896/11, më 20.03.2018

Gj y q t a r j a,
Naime Ahmeti

KËSHILLËJURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.